

Kur mund të tërhiqen shumat e akumuluar në Fondin e Pensionit Vullnetar Smart Pension?

Çdo anëtar i Fondit ka të drejtë të përfitojë shumën e akumuluar në fond kur përmbush kushtet e mëposhtme të parashikuara në ligji:

- 1. Pension Pleqërie** - kur mbush moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;
- 2. Pension të Parakohshëm** - 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;
- 3. Pension Invaliditeti** - kur bëhet i paafte për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 4. Pension Familjar** - në rastin kur anëtarit vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

A mund të bëj tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension?

Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete, të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve dhe më konkretisht:

- **2% (dy përqind)**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
- **5% (pesë përqind)**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të:
- **10% (dhjetë përqind)**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të:
- **15% (pesëmbëdhjetë përqind)**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të:

Shënim: Në rastin e vdekjes së anëtarit penaliteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

**FILLO TË KURSESH SA MË HERËT,
QË TË PËRFITOSH NGA INTERESI
I PËRBËRË.**

 **ALBSIG
INVEST**



 Rr. Barrikadave, Pallati "Albsig", Kati 8, Tiranë.

 +355 69 609 9922

 +355 4 22 54 764

 info@albsiginvest.al

 www.albsiginvest.al

MË SKANO



Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension

Çfarë është Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension?

Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension është i përbërë nga një grup asetesh, të investuara nga kontributet e anëtarëve dhe zotërohet bashkërisht nga të gjithë anëtarët ku pjesët përpjestimore të pronësisë përfaqësohen nga kuota në fond.

Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension është një alternativë për të patur një pension shtesë përveç pensionit shtetëror.

Fondi i adresohet klientëve konservatorë me tolerancë të ulët rreziku. Fondi do të investojë vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë investimi me rrezikun më të ulët ndër investimet e tjera në tregun e kapitaleve.

Fondi është krijuar për të shmangur problematikat e sistemit shtetëror të pensioneve, ku si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë nuk u siguron të ardhura të mjaftueshme një pjese të madhe të popullsisë kur arrijnë moshën e pensionit.

Cilat janë mënyrat e anëtarimit në Fondin e Pensionit Vullnetar Smart Pension?

Skemës Profesionale:

Në skemën profesionale punëdhënësi dhe punëmarrësi (individ) kontribuojnë së bashku në llogarinë e hapur për punëmarrësin (individin).

Skema Individuale:

Në skemën individuale vetëm individ (punëmarrësi) kontribuon në masën e dëshiruar.

Cilat janë përfitimet e biznesit në Fondin e Pensionit Vullnetar Smart Pension?

- Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij vlerësohen si shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250,000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet si shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin e punëdhënësit.
- Punëdhënësi përcakton në kontratë "vesting period", koha për të cilën punëmarrësi duhet të punojë në kompani për të përfituar këtë investim të punëmarrësit. Kjo periudhë është e përcaktuar në ligj dhe është jo më shumë se 2 vjet.
- Është pjesë e politikave të burimeve njerëzore, duke e diferencuar biznesin nga bizneset e tjera konkurrense.
- Ulje e "qarkullimit" të punonjësve.
- Punonjës më produktiv.

Cilat janë përfitimet e individit në Fondin e Pensionit Vullnetar Smart Pension?

- Kontributet individuale janë të zbritshme nga paga bruto për efekt llogaritje të tatimit mbi të ardhurat personale.
- Fondi i Pensionit Vullnetar Smart Pension është i trashëgueshëm dhe i transferueshëm.
- Depozitim i shumave të vogla nën minimumin e kërkuar të depozitave apo të bonove të thesarit dhe mundësia e kryerjes së pagesave në mënyrë automatike çdo muaj.
- Mundësia e kthimit të investimit të akumuluar në pagesa në formë pensioni, duke vijuar të akumulosh sërish interesa.
- Fondet e pensionit ofrojnë diversifikimin e investimeve në krahasim me investimet individuale.
- Investimet menaxhohen nga profesionistë të specializuar për të kryer investimet e duhura për Fondin e Pensionit.
- Transparencë e plotë. Anëtarët pajisen me një përdorues dhe fjalëkalim, të cilin mund ta përdorin për të monitoruar online në çdo kohë llogarinë e tyre personale.
- Pensioni shtetëror aktualisht zëvendëson mesatarisht vetëm 37.6% të të ardhurave tuaja aktuale, ndërkohë që kjo shkallë zëvendësimi duhet të jetë të paktën 75%, në mënyrë që të ruani një standard të mirë jetese edhe gjatë kohës së pensionit.

Përfitimet e të kursyerit në një kohë sa më të hershme:

	Rasti 1: Kursimi i hershëm	Rasti 2: Shtyrja e kursimit për më vonë
Metoda e kursimit	Investon 5,000 lekë në vit për 10 vitet e para dhe më pas nuk investon për 20 vitet në vijim.	Nuk investon gjatë 10 viteve të para, por investon më pas për 20 vite në vijim në vlerën 5,000 lekë në vit.
Shuma totale e kursyer	5,000 x 10 = 50,000 lekë	5,000 x 20 = 100,000 lekë
Vlera në fund të 30 viteve	175,206 lekë	173,596 lekë

Shembull për përfitimin tatimor nga zbritja/kursimi nga paga bruto (në lekë):

	Arbeni	Blerina
Paga bruto	85,000	85,000
Kontributi në Fondin "Smart Pension"	0	5,000
Paga e tatueshme	85,000	80,000
Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	7,150	6,500
Paga mbas tatimit	77,850	76,110
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,520	9,520
Paga neto	68,330	68,980
Kursimi pas pagesës së tatimeve	5,000	0
Të ardhurat neto pas kursimeve	63,330	68,980
Përfitimi fiskal	650 lekë	

Si realizohet konvertimi i kontributeve në kuota?

Shoqëria Administruese konverton në kuota pensioni kontributet e investuara në Fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër, sipas çmimit të kuotës të një dite më parë. Çdo kuota pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilën nga asetet e Fondit.

Shembulli i blerjes së një kuote pensioni:

Çmimi i kuotës së pensionit:	1,500.00 lekë
Kontributi	3,000.00 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (3,000.00 lekë / 1,500.00 lekë)	2 kuota

Nëse pas një periudhe të caktuar çmimi i kuotës do të rritet në 1,600 Lekë, vlera e aseteve të anëtarit do të jetë e barabartë me 2 (kuota) x 1,600 lekë x 3,200 lekë.

Si bëhet pagesa e kontributeve?

Çdo pagesë kontributesh do të kryhet në degë ose përmes kanaleve digjitale bankare në numrin e llogarisë së Fondit të Pensionit **IBAN: AL3620511007000803BLFIRLALLF**, të hapur pranë bankës depozitare, **Banka Kombëtare Tregtare Sh.a**, me të cilën shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje.

Cilat janë mënyrat e tërheqjes së Pensionit?

Asetet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

- Pagesë e menjëhershme e të gjithë vlerës ose e një vlerë të pjeshme të akumuluar;
- Pagesë periodike e planifikuar në formë pensioni;
- Përdorim i shumës së akumuluar për të blerë një "anuitet".

Cilat janë tarifat e Shoqërisë Administruese?

Shoqëria Administruese aplikon tarifat e mëposhtme:

- Tarifa e administrimit të Fondit është 1.5% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Kjo tarifë është më e ulta në tregun shqiptar që aplikohet për administrimin e Fondeve të Pensionit.
- Në rastin e transferimit të aseteve nga anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet e përcaktuar në ligj është 0.5% e shumës së transferuar.